

## 1.2. Migracioni i Parregullt

Përkufizimi i termit Migracion i parregullt sipas fjalorthit për Migracionin, e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin:

*“Lëvizja e personave që kryhet jashtë ligjeve, rregullave apo marrëveshjeve ndërkombëtare që rregullojnë hyrjen në ose daljen nga shteti i origjinës, tranzitit ose destinacionit.”<sup>1</sup>*

(Nuk ka një përkufizim të pranuar ose të qartë ndërkombëtarisht të migracionit të parregullt)

### **Rreziqet e Migracionit të Parregullt:**

- Migrantët në situatë të parregullt janë veçanërisht të pambrojtur nga shfrytëzimi, abuzimi dhe diskriminimi.
- Këta migrantë rrezikohen të shfrytëzohen nga

---

<sup>1</sup> <https://publication.iom.int>

	<p>organizatat kriminale të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandën e migrantëve, krime që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të viktimave. Edhe pse trafikimi i qenieve dhe kontrabanda e migrantëve janë dy vepra penale të ndara, shpesh, këto dy dukuri mbivendosen. Në kontekstin e shtimit të kontrollit në kufi, për të parandaluar migracionin e rregullt, shumë migrantë potencialë i'u drejtohen grupeve të krimit të organizuar për të mundësuar kalimin e kufirit për ta. Migrantët e kontrabanduar, përgjithësisht, janë të pavetëdijshëm për rreziqet e përfshira në këto transaksione dhe, shpesh, bien viktima të abuzimit nga grupet e krimit të organizuar. Përveç kësaj, ata janë të ekspozuar për t'u bërë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore.</p>
<p><b>Pasojat e Migracionit të Parregullt:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një numër i madh i migrantëve nga Shqipëria, bien pre e grupeve kriminale, të cilët mbështesin format e migracionit dhe qëndrimit në vendet e huaja në mënyrë të parregullt.</li> <li>• Janë të ekspozuar ndaj dënimeve dhe ndalimeve të udhëtimit për një kohë të gjatë.</li> <li>• Rrezikojnë të ardhurat financiare, por edhe lirinë si shkak i skemave mashtruese nga trafikantët.</li> <li>• Në rast të thyrjes së periudhës së lejuar të qëndrimit ( 90 ditë në zonën Schengen si vizitor, përballen me pasojat e mundshme siç janë: gjobat, arrestimet, ndalimi në një nga vendet e BE-së, deportimi (kthimi mbrapsht, ndalimi i hyrjes në zonën Schengen deri në një periudhë 5 – vjeçare.</li> <li>• Shtetasit Shqiptarë pasi kthehen nga emigrimi janë më të varfër, kjo si pasojë e shitjes të pasurisë për një jetë më të</li> </ul>



	mirë
<p><b>1.3. Pasojat e Migracionit të parregullt dhe vulnerabiliteti i fazave të ndryshme të procesit të migracionit tek gratë.</b></p>	
<b>Vulnerabilitetet e fazave të ndryshme të procesit të migracionit tek gratë<sup>2</sup></b>	<b>Përvoja e grave punëtore migrante</b>
<b>Faza e migracionit dhe Rekrutimi para nisjes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rënia viktimë e rekrutuesve të paligjshëm/kriminalë dhe trafikantëve</li> <li>• Mashtrimi, ngacmimi dhe zhvatja nga agjenci dhe ndërmjetës</li> <li>• Politika kufizuese migracioni që prekin gratë</li> <li>• Shfrytëzimi në “qendra trajnimi”</li> <li>• Dhuna me Bazë Gjinore</li> </ul>
<b>Udhëtimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Risku për hyrje klandestine ose kontrabandim, sidomos mjete të pasigurta udhëtimi, ngacmim dhe sulm seksual nga elementë kriminalë, ndalimi me dokument false, etj.</li> </ul>
<b>Puna dhe jetesa jashtë vendit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zëvendësimi i kontratave me ato që ofrojnë paga dhe kushte pune, strehim nën standard, duke i diskriminuar grate bazuar në gjini etj.</li> <li>• Në disa vende, të drejta të mohuara për gratë</li> <li>• Mbajtja e pasaportave dhe dokumenteve të udhëtimit</li> <li>• Mungesa e sigurimit të duhur për të mbuluar trajnimin/kujdes mjekësor dhe akses në kujdesin shëndetësor riprodhues</li> <li>• Abuzim ose dhunë seksuale, psikologjike ose fizike</li> <li>• Mungesa e aksesit në shërbime dhe mekanizma dëmshpërblimi</li> <li>• Risku i ndalimit të pasigurt jo gjinor në rastin e statusit të parregullt ose të pa dokumentuar</li> </ul>

<sup>2</sup><https://albania.iom.int/sites/g/files/tmzbd11401/files/documents/Training%20Manual%20on%20Migration%20Governance%20for%20Albanian%20Government%20Officials.pdf>

<p><b>Ndërprerja e kontratës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Risku i ndërprerjes para kohe të punësimit</li> <li>• Mungesa e mundësisë të efektshme për ankimim dhe për makinerinë e dëmshpërblimit</li> </ul>
<p><b>Kthimi dhe riintegrimi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e burimit alternativ të të ardhurave dhe vështirësi në gjetjen e punësimit sidomos për gra për shkak të diskriminimit gjinor në tregun e punës</li> <li>• Probleme familjare dhe rregullime, divorci, dhuna me bazë gjinore</li> <li>• Vështirësi të riintegrit social, sidomos për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore jashtë shtetit.</li> <li>• Rreziku i ri-trafikimit</li> </ul>